



# MBRETNIA SHQIPTARE

## DREJTORIJA E SHKOLLËS NORMALE

"LUIGJ GURAKUQI,"

ELBASAN

Nr. Prot. 24/Res

Elbasan, më 20/IV/ 1943 -XXI

Shkurtimi: Kërkohet transferimi i kopshtarit, Dervish Baba.

Gjegje shk. Nr. \_\_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_

P . T .

MINISTRIS S'ARSIMIT

T i r a n ë

Kemi nderin t'Ju njoftojmë se her'pas-here, profesprët e bujqësis në kët Institut, kanë raportue mbi sjelljet e pa pëlqyeshme e neglizhencën në detyrë të kopshtarit të kësaj Shkolle, z. Dervish Babës.

Në raportet e dhanuna profesorët përshkruejnë se kopsatri në fjalë, jo vetëm që u paraqitka vonë në punë, tue ardhë edhe i dejun, por në këto dit i janë zhdukë në kopësht një sasi e madhe fildanesh.

Megjithë që i përmenduni asht këshillue dhe i asht tërhekë verejtja për mungesat që ushtron, por e deri mëssot nuk ka ndryshue e ca ma keq vjen tue i u-shmangë ma tepër detyrës.

Për të gjitha arsyet e parashtrueme kjo Drejtori, tue qenë edhe vetë e sigurtë, kërkon nga ajo P.T. Ministri që kopshtari në fjalë të transferohet nga ky Institut e, në vend të tij, t'emnohet një tjetër ase t' autorizohemi me zgjedhë një tjetër person, sa ma parë që të jetë e mundun.

Drejtori i Normales "L. GURAKUQI"

(Prof. Ibrahim Babamusta)